



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.612/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomik “GP Medical AI” shpk & “Medikanova” Shpknjp në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr.REF-64825-07-09-2020 me objekt Loti 7 “*Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë*” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 127,480,750 (njëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: BOE “GP Medical AI” & “Medikanova” Shpknjp
Mucaj, Rruga Nacionale e Vjetër, Vorë

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr.REF-64825-07-09-2020 me objekt Loti 7 “*Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë*” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 127,480,750 (njëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 31.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- GP Medical Al 98,302,092 I skualifikuar
- Biometric Albania 105,507,000 I skualifikuar
- OES Distrimed 125,971,300 I kualifikuar

II.4. Në datën 21.10.2020 operatori ekonomik “GP Medical Al” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Skualifikohet pasi nuk përmbush kriteret e vecanta te kualifikimit, konkretisht, nuk plotëson kriterin e kërkuar në pikën 1, gërma c) ku (Kerkohet të paraqitet Sigurimi i ofertës sipas shtojcës 4) pasi: BOE GP MEDICAL AL dhe MEDIKANOVA SHPKNJP kanë paraqitur sigurimin e ofertës me vlerën e saktë dhe të vlefshme në kohezgjatje, në emer të përfaqesuesit, i cili me prokurë të posacme është GP MEDICAL AL, por pa specifikuar emrin e plotë të BOE. Në bazë te VKM, Nr.914, datë 29.12.2014 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni Neni 74, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2 citohet shprehimisht: “Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.” Oferta e paraqitur nga ky BOE e ngarkuar në SPE është paraqitur ne emer te BOE si një ofertë e vetme e këtij BOE. Pra ofertuesi i VETEM ne kete rast është BOE GP MEDICAL AL shpk dhe MEDIKANOVA ShPKNJP dhe jo GP MEDICAL AL shpk. Si rrjedhojë, edhe sigurimi i ofertës DUHET të specifikojë emrin e ofertuesit të vetem që ne këtë rast është BOE: GP MEDICAL AL shpk dhe MEDIKANOVA ShPKNJP. Në prokurën e posacme Nr. 2848 Rep. Nr 1692*

Kol. OE GP MEDICAL shpk është autorizuar të: "...përfaqësojë të dy operatorët ekonomik që bëjnë pjesë në këtë "Grup", duke dorëzuar ofertën, të lidhi kontratën me Autoritetin Kontraktor në rast të shpalljes fitues, si dhe cdo lloj dokumentacioni ligjor të kërkuar për këtë qellim, të urdhërojë këtë bashkim dhe të gjithë anëtarët e saj vec e vec për kryerjen e të gjitha veprimeve për realizimin e kontratës sic e parashikon ligji "Për prokurimin publik" I ndryshuar, për pjesëmarrje në tender si dhe cdo tratativë tjetër të këtij bashkimi të përkohshëm deri në përfundim të afatit të kontratës si dhe ekzekutimin plotësisht të saj." Sigurimi i ofertës është bërë nga Operatori Ekonomik GP MEDICAL AL shpk, përfaqësues i Bashkimit të Operatorëve GP MEDICAL AL dhe MEDIKANOVA SHPKNJ, dhe pa specifikuar në "Formularin e sigurimit të ofertës", pjesëmarrjen e shoqërisë MEDIKANOVA ShPKNJ, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në Pikën 2.3.8 ku (Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofertuar. (Katalogët duhet të ngarkohen në e.ee.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe specifikisht si më poshtë: -Nga verifikimi i mostrave dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga ana e BOE GP MEDICAL AL shpk dhe MEDIKANOVA ShPKNJ për këtë procedurë prokurimi, rezulton që ky BOE nuk ka sjellë dokumentacion vërtetues për të plotësuar kërkesat në specifikimet teknike lidhur me artikujt Nr. 54, Nr. 55 dhe Nr. 56. Dokumentacioni i paraqitur nga BOE, për përmbushjen e kriterit për artikujt 54, 55 dhe 56 lidhur me faktin që stentet me diametër 4.0mm, me procedurën e post-dilatacionit zgjerohen deri në përmasat 4.5mm dhe 5.5mm, me ndihmën e ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot, për të arritur përmasat e kërkuara për artikujt Nr. 54, Nr. 55 dhe Nr. 56, nuk merret parasysh nga specialistët e fushës, sepse nuk është në përputhje me kërkesat në DST të cilat janë specifike fikse të mirëpërcaktuara dhe të kërkuara nga shërbimet e spitaleve, të nevojshme për ofrimin e një shërbimi mjekësor sa më cilësor ndaj pacientit. Për më tepër, pranimi i kësaj oferte do t'i vendoste OE e tjerë pjesëmarrës në kushte jo të barabarta, pasi sikundër evidentohet në këtë procedurë ky BOE për të plotësuar specifikimet teknike të artikujve të kërkuar në DST, ka ofertuar edhe një produkt shtesë(ballonin), që nuk është kërkuar nga ana e AK. Për sa kohë që në DST ka të mirë përcaktuara specifike teknike për cdo artikull dhe kriteret teknike të kërkuara për të vërtetuar plotësimin e tyre të gjithë OE kanë detyrimin të paraqesin dokumentacionin për përmbushjen e tyre, pasi kanë pasur të gjithë kohën e duhur në dispozicion për të bërë kërkesa për sqarime në lidhje me cdo paqartësi që mund të kenë pasur. Për sa më sipër, specialistët e fushës në unanimitet vlerësojnë se oferta e BOE GP MEDICAL AL shpk dhe MEDIKANOVA ShPKNJ, nuk plotëson kriterin e kërkuar në Pikën 2.3.8(Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet

të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe), pasi mungojnë mizurat (përmasat) 4.5mm dhe 5.0mm. Pasi në katalogët e paraqitur për artikujt 54, 55,56 nuk gjenden mizurat (përmasat) 4.5mm dhe 5.0mm të kërkuara në DST konkretisht: Është kërkuar: 54-Diameter 4.5mm, gjatesi 18-20mm 55-Diameter 4.5mm, gjatesi 21-24mm 56-Diameter 5.0mm, gjatesi 11-12mm, Është paraqitur: Stent me diametër 4.0mm, që me procedurën e post-dilatacionit zgjerohen deri në përmasat 4.5mm dhe 5.0mm, me ndihmën e ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot, për të arritur përmasat e kërkuara për artikujt Nr. 54, Nr. 55 dhe Nr. 56.

II.5. Në datën 27.10.2020 BOE “GP Medical Al” shpk& “Medikanova“ shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Sigurimi i ofertës i paraqitur nr.serial 8370003 nga shoqëria Albsig është paraqitur vetëm në emër të operatorit GP Medical Al. Sipas KVO ky sigurim nuk është sipas ligjit për prokurimin publik. I kujtojmë autoritetit se sigurimi i ofertës kërkohet për të garantuar autoritetin dhe autoritetit i mjafton që të lëvrojë shumën e sigurimit nga shoqëria e sigurimit dhe jo marrëdhënia juridike civile mes shoqërisë së sigurimit dhe siguruesit. Pra thënë thjesht sigurimi nëse vërtetohet kushtet ekzekutohet në emër të autoritetit kontraktor në masën e plotë e cila sipas KVO është vlerësuar e saktë. Gjithashtu në kontratën e bashkëpunimit nr.2847 rep nr.1691 kol datë 20.08.2020 në nenin 3 dhe 6 është parashikuar se ky sigurim do të bëhet nga ana e operatorit GP Medical Al. Aq më tepër në nenin 3 janë përcaktuar sipas ligjit dhe përqindjet e pjesmarrjes në të drejta dhe detyrime si dhe përgjegjësi solidare e palëve. Në këtë optikë vlerësimi i KVO është i gabuar pasi nuk ka asnjë shmangie nga legjislacioni në fuqi dhe sigurimi i ofertës realizon qëllimin për të cilin është vendosur nga legjislatori në dispozitën që citon KVO në arsyet e saj. KVO nuk ka shprehur asnjë kundërshtim lidhur me kontratën e bashkëpunimit duke pranuar atë si ligjërish të vlefshme.
- Lidhur me mosparaqitjen e artikujve nr.54,55 dhe 56 AK pretendon se paraqitja e stentës me diametër 4.0 mm e cila zgjerohet në përmasat 4.5 mm dhe 5.0 mm me procedurën e post dilatacionit me ndihmën e ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot nuk merret parasysh nga specialistët e fushës pasi nuk është në përputhje me kërkesat e mirëpërcaktuara dhe të kërkuara nga shërbimet spitalotr të nevojshme për ofrimin e një shërbimi mjekësor sa më cilësor për pacientin . Për më tepër thotë AK pranimi i ofertës sonë do të conte OE të tjerë pjesmarrës në kushte jo të barabarta pasi për të plotësuar specifikimet teknike subjekti ynë ka ofruar edhe balonin si produkt shtesë produkt ky që nuk është kërkuar nga AK. Bëjmë me dije se Ballonin NC Trek ne do ta ofrojmë falas.

Lidhur me këtë arsye subjekti ynë sqaron se kompania Abbot është prodhuesi më i madh dhe lider botëror në fushën e stentave koronare, Abbott është një prodhues amerikan. Kur prodhuesi Abbott nxjerr një produkt në shitje sic është rasti i stentave dhe balonave të paraqitura për artikujt 54,55 dhe 56 i nxjerr vetëm pas marrjes së aprovimit nga trupat akredituese CE dhe FDA amerikane për përshtatshmërinë e tyre me direktivat dhe legjislacionin në fushën e pajisjeve mjekësore si dhe pas eksperimenteve e studimeve që vërtetojnë sigurinë e tyre për të ofruar shërbimin më cilësor për pacientin. Përmasat e kërkuara për produktet 54,55 dhe 56 janë shumë të rralla dhe pothuajse asnjëherë të kërkuara nga shërbimet spitalore. Për statistikë ju lutemi AK Ministria e Shëndetësisë të nxjerri sa herë janë kërkuar këto stenta gjatë këtyre viteve.? Ne na rezultojnë që zero. Abbott në katalogun në file Autorizime Biotronik Abbott +Xience Sierra Katalog faqe 27 e reklamon produktin me përmasat e reja shihni tabelën përkatëse si dhe në file Katalog të Markuar faqe 11 rikonfirmon këto përmasa.

Prodhuesi Abbott për të aritur këto dimensione shumë rrallë të kërkuara nuk i dedikon një linjë të vecantë prodhimi por përmes inovacionit përdor ballonën NC Trek të miratuar me cdo certifikatë të mundshme për të plotësuar këtë boshllëk në numrat e mëdhenj që për hir të ankesës po theksojmë se vetëm dy prodhues i prodhojnë këto përmasa (me shumë mundësi fituesi i deritanishëm i kësaj procedure ka ndonjë nga këto shoqëri prodhuese). KVO gjithashtu thekson se ne kemi pasur të gjithë mundësitë për të bërë kërkesa për sqarim në lidhje me cdo paqartësi që mund të kemi patur. Në kundërshtim me KVO ne nuk kemi patur asnjë paqartësi pasi për ne mjafton që të arrihet dimensionin i kërkuar. Stenta Abbott mund të zgjerohet deri në 5.5 mm në dimetër pa shkurtuar gjatësinë e kërkuar (katalogu Xcience Sierra faqe 100) ndërkohë stentat e prodhuesve të tjerë i arrijnë këto përmasa duke shkurtuar gjatësinë e stentës (verifikojeni këtë pohim me mjekët e spitaleve).

- Në mungesë të një udhëzimi apo kriteri specifik sesi arrihen këto përmasa ose për numrin e pajisjeve që do të përdoren apo metodën sesi do të aplikohet shoqëria jonë ka ofruar produktet e Abbott që në aspektin teknologjik dhe funksional arrijnë përmasën e kërkuar të vërtetuar shkencërisht me studimet përkatëse për të cilat KVO nuk ka shprehur asnjë kundërshtim. Stenta XCIENCE Sierra në katalogun e saj përcakton se është e zgjerueshme. Në respekt të frymës së LPP neni 23 pika 5 ku termi ekuivalent shoqëron specifikimet teknike i përdorur ky term edhe në DT në specifikimet teknike si dhe në shtojcën 10 të DT ne kemi ofruar një zgjidhje ekuivalente. Në të kundërt nëse nuk do të ekzistonte parimi i ekuivalencës atherë ky tender është qepur për vetëm një ose dy prodhues në botë.
- Për sa i përket mospranimit të këtij produkti nga specialistët e fushës të zgjedhur nga ju nuk e kuptojmë sesi ata kanë shprehur mospranimin e tyre kur ky produkt është pranuar gjërësisht në tregun amerikan european botëror nga mjekë e shkencëtarë plus ka marrë cdo certifikim të mundshëm të kërkuar dhe paraqitur në këtë procedurë për të cilën KVO nuk ka shprehur asnjë kundërshtim duke pranuar vërtetësinë e tyre. Të gjitha detajet e mësipërme shoqëria jonë nuk i ka fshehur por i ka konfirmuar vetë përmes një deklarate sqaruese të hedhur në SPE përpara hapjes së ofertave.

- *Për sa i përket diskriminimit të operatorëve të tjerë ky pretendim është jorelevant pasi nuk kuptojmë sesi po i diskriminojmë operatorët e tjerë përkundrazi ne ndjehemi të diskriminuar pasi kemi sjellë produkte gjermane dhe amerikane në procedurë me cmim disa herë më të ulët se në gjithë historinë e shërbimit spitalor shqiptar, emrat më të mëdhenj dhe të sigurt për pajijet mjekësore të kardiokirurgjisë , ofrojmë zgjidhje novatore pa kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe nuk shpallemi dot fitues. Fakti që ne jemi të ndryshëm në zgjidhjen novatore të ofruar nuk është problemi ynë por OE e tjerë kanë qenë të lirë të ofrojnë cdo zgjidhje të mundshme.*
- *Sipas LPP KVO ka të drejtë të kryejë verifikimet përkatëse atherë ftojme KSHA bashkë dhe me KVO të kryejnë verifikimet përkatëse pranë Abbott ose pranë cdo spitali kudo në botë për të verifikuar me fakte dhe argumenta shkencore zgjidhjen e ofruar nga Abbott për produktet 54,55,56. Edhe sikur të mohohet e drejta jonë do ju luteshim këtë ta bënit në bazë shkencore dhe jo thjesht duke thënë nuk pranohet e nuk plotësohet kriteri.*
- *Në katalogun e markuar produktet 54,55, dhe 56 janë deklaruar në përmasat përkatëse sipas dokumentave të tenderit dhe rrjedhimisht plotësojnë kriteret dhe specifikimet e kërkuara nga AK . Zgjerueshmëria e stentës me ballon është njohur edhe nga KVO pasi thekson disa herë që ajo është e zgjerueshme . Post Dilatacioni nuk krijon asnjë efekt negativ të pacientit. Studimi XCIENCE Exppandable në faqet 4 dhe 6 të tij shprehen për pranimin nga studiuesit të efektit të zgjerueshëm ku theksohet se DES XCIENCE ka një performancë më të mirë se DES e tjerë në terma të fleksibilitetit , fortësisë radiale dhe zgjerueshmërisë maksimale.*
- *Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.*

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se me shkresën nr.3256/28 prot datë 02.11.2020 autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës. Në parashtrimet në KPP ankimuesi pretendon se AK nuk ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën as në afatin prej 7 ditësh as në ditët pas afatit.

II.7. Në datën 12.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.3256/30 prot datë 18.11.2020 protokolluar me tonën me nr.1479/2 prot datë 19.11.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën Nr.1479/5 prot datë 24.12.2020 me lëndë seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi palët në proces lidhje me mbajtjen e një seance dëgjimore për çështjen objekt shqyrtimi në datën 29.12.2020 ora 12:00.

II.10. Në datën 29.12.2020 ora 12:00 u mbajt seanca dëgjimore me 2 përfaqësues të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “GP Medical AI” shpk& “Medikanova“ shpk dhe 3

përfaqësues të autoritetit kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, njëri prej të cilëve ekspert i fushës i cili nuk ka qenë i përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këtë seancë u mbajt procesverbali përkatës pjesë e dosjes objekt shqyrtimi. Në seancën dëgjimore autoriteti kontraktor dhe BOE ankimues rezervuan të drejtën e paraqitjes me shkrim të disa sqarimeve shtesë në mbështetje të argumentave të dhëna në seancën dëgjimore.

II.11. Në datën 29.12.2020 autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe BOE ankimues në vijim të seancës dëgjimore kanë dorëzuar pranë KPP sqarimet përkatëse, informacione shtesë në lidhje me disa detaje teknike dhe argumente mbështetese lidhur me diskutimet në seancë dëgjimore dhe me procedurën në tërësi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “GP Medical Al” & “Medikanova” Shpknj për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “*Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në Pikën 2.3.8 ku (Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe specifikisht si më poshtë: -Nga verifikimi i mostrave dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga ana e BOE GP MEDICAL AL shpk dhe MEDIKANOVA ShPKNJ për këtë procedurë prokurimi, rezulton që ky BOE nuk ka sjellë dokumentacion vërtetues për të plotësuar kërkesat në specifikimet teknike lidhur me artikujt Nr. 54, Nr. 55 dhe Nr. 56. Dokumentacioni i paraqitur nga BOE, për përmbushjen e kriterit për artikujt 54, 55 dhe 56 lidhur me faktin që stentet me diametër 4.0mm, me procedurën e post-dilatacionit zgjerohen deri në përmasat 4.5mm dhe 5.5mm, me ndihmën e ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot, për të arritur përmasat e kërkuara për artikujt Nr. 54, Nr. 55 dhe Nr. 56, nuk merret parasysh nga specialistët e fushës, sepse nuk është në përputhje me kërkesat në DST të cilat janë specifike fikse të mirëpërcaktuara dhe të kërkuara nga shërbimet e spitaleve, të nevojshme për ofrimin e një shërbimi mjekësor sa më cilësor ndaj pacientit.*

Për më tepër, pranimi i kësaj oferte do t'i vendoste OE e tjerë pjesëmarrës në kushte jo të barabarta, pasi sikundër evidentohet në këtë procedurëky BOE për të plotësuar specifikimet teknike të artikujve të kërkuar në DST, ka ofruar edhe një produkt shtesë(ballonin), që nuk është kërkuar nga ana e AK. Për sa kohë që në DST ka të mirë përcaktuara specifikime teknike për cdo artikull dhe kriteret teknike të kerkuara për të vërtetuar plotësimin e tyre të gjithë OE kanë detyrimin të paraqesin dokumentacionin për përmbushjen e tyre, pasi kanë pasur të gjithë kohën e duhur në dispozicion për të bërë kërkesa për sqarime në lidhje me cdo paqartësi që mund të kenë pasur. Për sa më sipër, specialistët e fushës në unanimitet vlerësojnë se ofertat BOE GP MEDICAL AL shpk dhe MEDIKANOVA ShPKNJ P, nuk plotëson kriterin e kërkuar në Pikën 2.3.8(Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në eëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe), pasi mungojnë mizurat (përmasat) 4.5mm dhe 5.0mm. Pasi në katalogët e paraqitur për artikujt 54, 55,56 nuk gjenden mizurat (përmasat) 4.5mm dhe 5.0mm të kërkuara në DST konkretisht: Është kërkuar: 54-Diameter 4.5mm, gjatesi 18-20mm 55-Diameter 4.5mm, gjatesi 21-24mm 56-Diameter 5.0mm, gjatesi 11-12mm, Është paraqitur: Stent me diametër 4.0mm, që me procedurën e post-dilatacionit zgjerohen deri në përmasat 4.5mm dhe 5.0mm, me ndihmën e ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot, për të arritur përmasat e kërkuara për artikujt Nr. 54, Nr. 55 dhe Nr. 56”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

8. Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në eëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe)

9. Kërkohen të paraqiten studime multicentrike të randomizuara (të përkthyer dhe të noterizuara)

10. Kërkohen mostra për të gjithë artikujt e kërkuar si më poshtë:

- Stente të veshura me medikament për ristenozë – I cope

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosura/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës 2020, ora ____ : ____.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

Lot7 Drug-eluting stent for restenosis- stentta te medikuara per restenoze

Drug-eluting stent for restenosis, LM and bifurcation, Obligatory characteristics: **Coronary stent that releases drug (drug-eluting) made of cobalt alloy (CoCr) or Platinum (PtCr)**, markers of platinum iridium, **sinusoidal technology connecting from one wire, or in combination CËT technology, Multi-link technology or combination of mentioned technologies or equivalent**, with the active component - cytostatic either anti-inflammatory and antiproliferative activity - Everolimus, Zotarolimus or Serolimus. **The drug carries BioLinx polymer, or fluoropolymer, or PVDF or an equivalent polymer with drug delivery through 120 to 180 days or equivalent**, tested in multicentric studies for their efficacy, CE approval for use in patients either diabetes or equivalent. (Stente te veshura me medikamente citostatike: Stente te veshura me me dikament per ristenoza, LM dhe bifurkime, Karakteristika te detyrueshme: Stent koronar që lëshon ilaç (i medikuar) e përbërë prej aliazh Kobalti (CoCr) ose Platini (PtCr)”, markues platinum iridium, teknologji sinusoidale me lidhje nga një tel, teknologji CËT, teknologji Multi-Link ose kombinim i teknologjive të sipërpërmendura, ose ekuivalente me komponent aktiv, citostatik Everolimus, Zotarolimus ose Serolimus me aktivitet anti-inflamator dhe anti-proliferativ, Mbajtësi i ilaçit BioLinx polymer ose Fluoropolymer ose PVDF ose polimer ekuivalent shpërndan ilaçin në 120 deri në 180 ditë ose ekuivalent, te provuara ne studime multicentrike per efikasitet, CE per perdorim ne pacient diabetik ose ekuivalent)

Diameter 2.0mm, gjatesi 11-12mm	cope
Diameter 2.0mm, gjatesi 15-16mm	cope

Diameter 2.0mm, gjatesi 18-20 mm	cope
Diameter 2.0mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 2.0mm, gjatesi 26-28mm	cope
Diameter 2.0mm, gjatesi 29-33mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 7-8mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 11-12mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 15-16mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 18-20mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 25-28mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 29-30mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 32-34mm	cope
Diameter 2.25mm, gjatesi 37-38mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 7-8mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 11-12mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 15-16mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 18-20mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 25-28mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 29-30mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 32-34mm	cope
Diameter 2.50mm, gjatesi 37-38mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 7-8mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 11-12mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 15-16mm	cope

Diameter 2.75mm, gjatesi 18-20mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 25-28mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 29-30mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 32-34mm	cope
Diameter 2.75mm, gjatesi 37-38mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 7-8mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 11-12mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 15-16mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 18-20mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 25-28mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 29-30mm	cope
Diameter 3mm, gjatesi 32-34mm	cope
Diameter 3.0mm, gjatesi 37-38mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 7-8mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 11-12mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 15-16mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 18-20mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 25-28mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 29-30mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 32-34mm	cope
Diameter 3.5mm, gjatesi 37-38mm	cope
Diameter 4.0mm, gjatesi 11-12mm	cope

Diameter 4.0mm, gjatesi 15-16mm	cope
Diameter 4.5mm, gjatesi 18-20mm	cope
Diameter 4.5mm, gjatesi 21-24mm	cope
Diameter 5.0mm, gjatesi 11-12mm	cope

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE ankimues në përmbushje të kriteve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Nr. 2847 Rep dh nr.1691 Kol datë 20.08.2020 lidhur ndërmjet Shoqërisë GP Medical AI shpk dhe Shoqërisë Medikanova shpk për realizimin e objektit Loti 7 “*Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë, zhvilluar nga Minsitria e Shëndetësië dhe Mbrojtjes Sociale. Shoqëria GP Medical AI shpk është pjesmarrëse në tender me 2% ndërsa Shoqëria Medikanova shpk është pjesmarrëse me 98%.*
- Katalogë të prodhuesit *Abbot Xience Pro A* nga ku rezulton se për artikujt 54,55,56 është markuar stenta me diametër 4.0 mm . Në katalog deklarohet se me anë të ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot arrihet diametri i kërkuar-maksimumi i zgjerimit për stentat me diametër 3.5 mm dhe 4 mm me anë të ballonit është 5.5 mm.
- Inventar Lista e Mostrave të dorëzuara ku ndër të tjera deklarohet si më poshtë:
- Artikulli Nr. 54 diamatër 4.5 mm gjatësi 18-20 mm Xience Sierra+1012454-12, 1012455-20, 1012454-20 NC Trek Abbott Vascular
- Artikulli Nr. 55 diametër 4.5 mm gjatësi 21-24 mm Xience Sierra+1012454-20 NC Trek Abbott Vascular
- Artikulli Nr.56 diametër 5.0 mm gjatësi 11-12 mm Xience Sierra+1012455-20 NC Trek Abbott Vascular
- Mostrat e paraqitura janë përfaqësuese sipas kategorizimit të produkteve. Për artikujt 54,55 dhe 56 po ofrojmë si mostër Xience Sierra me dimensione 4.0 mm x12 mm e cila është e përshtatshme me ballonat NC Trek me dimensione 4.5 mmx12 mm dhe 5.0 mm x12 mm. Sqarojmë se mostrat mund të përdoren nga KVO për të parë efektin e zgjerueshëm (expandable) të stentës Xience Sierra si kundërdeklaruar dhe demonstruar në katalogët përkatës për të arritur dimensionet e kërkuara për artikujt 54,55 dhe 56.
- Studime multicentrike të randomizuara

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]*”

Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”

III.1.5. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 23 pika 1,2 dhe 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”[...]”

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, dokumenteve të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi i final i autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi është furnizimi me stenta të medikuara për restenozë. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se procedura e prokurimit është organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila, referuar akteve nënligjore në fuqi ka një përgjegjësi dyfishe, atë të “d) Hartimin dhe përditësimin e të

gjitha protokollevë të mjekimit sipas praktikave bashkëkohore; dh) Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;” referuar Vendimit Nr. 508, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore Të Ministrisë Së Shëndetësisë Dhe Mbrojtjes Sociale” si edhe në cilësinë e Organit Qendror Blerës për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore, në përputhje me Vendimi nr.135 datë 20.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Lejimin e Ministrisë Së Shëndetësisë për Kryerjen E Procedurave Të Prokurimit Publik, Në Emër Dhe Për Llogari Të Institucioneve Të Varësisë, Për Disa Mallra E Shërbime”, ku ndër detyrat e tjera në cilësinë e organit qëndror blerës ka edhe të ç) të shqyrtojë dhe të miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qëndror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qëndror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

d) të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qëndror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se roli i paraparë nga ligjvënësi për këtë të fundit është ai një *quasi gjykate*, garant i zbatimit të ligjit për prokurimit publik dhe vecanërisht të parimit të transparencës dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve ndaj palëve. Për të garantuar nivelin më të lartë të mbrojtjes së interesit të ligjshëm të palëve në proces, Komisioni i Prokurimit Publik ka ndjekur të gjithë elementët proceduriale të kërimit të provës, për aq sa parashikohet në Kodin e Procedurave Administrative si edhe në *lex specialis* në rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik të miratuar me Vendimin nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.8. Në nenin 80 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” parashikohet se: “ Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: **a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;** b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.”

Gjithashtu, në nenin 64/1 gërma “ç” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se gjatë rishikimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) t’u kërkojë palëve dokumentacion ose të dhëna, për të mbështetur pretendimet e tyre; b) të kërkojë të dhëna e shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material, që ka lidhje me hetimin administrativ; c) të marrë në

pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me procedurën e rishikimit; **c) të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.**”

Kështu, Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës nr. 1479/5 prot datë 24.12.2020 me lëndë seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi palët në proces lidhje me mbajtjen e një seance dëgjimore për çështjen objekt shqyrtimi në datën 29.12.2020 ora 12:00, ndërkohë që autoritetit kontraktor i është kërkuar edhe prania e një eksperti të fushës. i cili të mos ketë qenë i përfshirë në vendimarrjen e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në datën dhe në orën e caktuar është zhvilluar seanca dëgjimore. Reflektuar në proces-verbalin e mbledhjes, pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë paraqitur një përfaqësues nga autoriteti kontraktor në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (znj. Joana Duro) Anëtarit të KVP Z. Leonard Simoni dhe Z.Agron Meshi në cilësinë e ekspertit të fushës që nuk ka patur lidhje me fazat e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Gjithashtu kanë marrë pjesë në seancë 2 përfaqësues të BOE ankime Z. Edvin Lico dhe Z. Petrusheski Ljuben .

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, përpara drejtimit të pyetjeve ndaj ekspertit i ka rikujtuar rëndësinë e funksioneve për të cilat është thirrur për t’i përmbushur ato me profesionalizëm me të vetmin qëllim që t’ia bëjë të ditur Komisionit të vërtetën, duke zbatuar kështu, për aq sa është e mundur në një shqyrtim administrativ, parimet e zhvillimit të ekspertizës referuar Kodit të Procedurave Civile. Nga ana e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk ka patur pretendime mbi përjashtimin e ekspertit.

III.1.10. Në këtë mënyrë, Komisioni i Prokurimit Publik ka vijuar me drejtimin e pyetjeve palëve, me qëllim zgjidhjen e konfliktit administrativ. Së pari, Komisioni i Prokurimit Publik ka drejtuar ekspertit pyetjen si vijon: *Cili është funksioni i materialit të mësipërm të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, me përmasat e parashikuar dhe konkretisht, për artikujt e listuar me numër rendor 54,55,56. **Cili është roli i diametrit në funksionalitetin?** KPP sqaron se pyetja e mësipërme lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me nenin 27 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku përsahikohet se: “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i **vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.**” Sa më sipër, KPP gjykon se në themel të konfliktit administrativ lidhet fakti nëse mallrat e ofruara nga BOE ankimes janë të pranueshme për funksionet e kërkuara.**

Nga ana e ekspertit është kthyer përgjigjia se: “*E pashe dokumentacionin. Normalisht në të gjitha praktikat e posdilimit ne posdilatojme stentin pershembull nga 4 mm e cojmë 4.5 mm. Ne rastin konkret kur stenti eshte 4 mm dhe ta zgjerosh deri në 5.5 ka pak aveture brenda. Nese nuk ka zgjidhje tjetër patjetër që do ja vendos pacientit por zgjerimi i stentit në këto dimetra mund të cojë në thyreje të stentit e cila krijon tromboze tek pacienti dhe i rrezikon jetën pacientit deri në limitet që mos ta nxjerrësh nga salla e operacionit. Pra sic po thoja nese une kam nje arterie me dimetër 6 mm nuk mund që me një stente 4 mm ta zgjeroj deri në 6 mm. Po them cfarë bëjmë normalisht ne sallën e operacionit. Praktika është e tillë ,*

normalisht e cojme nga 3 mm ne 3.5 mm, nga 4 mm në 4.5 mm por nuk mund ta zgjerosh nga 4 mm në 5.5 mm pasi kjo është të bësh spektakel dhe ekziston rreziku i mosnxjerrjes së pacientit nga salla. Ne ecim mbi bazen e disa studimeve. Stenti ofruar nga BOE ankimes është e me te mirat por diametrat nuk janë ato të duhurit, nuk jam dakord.

III.1.11. Së dyti, Komisioni i Prokurimit Publik ka drejtuar pyetjen “A ndryshon karakteristikat e materialit mjekësor, stenta me diametër 4 mm e cila zgjerohet sipas deklarimeve dhe propozimeve të ofertuesit në përmasat 4.5-5 mm në procedurën e post dilatacionit me ndihmën e ballonit Coronary Dilatation Catheter NC Trek të prodhuesit Abbot? A kryejnë të njëjtin funksion, pa ndryshuar karakteristikat thelbësore dhe **cënuar jetën dhe shëndetin e pacientëve**, stentat e paraqitura nga BOE ankimes në krahasim me stentat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Eksperti është përgjigjur si vijon - Po e demton se ky stent gjatë hapjes (zgjerimit) mund të thyhet duke shkaktuar trombozë tek pacienti. Ne vetem kur jemi ne kushte te shtrenguara e postdilatojme stentin. Ka raste qe ne nuk e postdilatojme nese stendi hapet vete. Stenti i ofruar nga BOE nuk shahet por sa i takon diametrit nuk jam dakord.

III.1.12. Në nivel procedural të zhvillimit të procedurës, është pyetur zyrtarja e prokurimit, në rolin e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si dhe anëtari i KVO se . “Cilat janë argumentat e autoritetit lidhur me mospranimin e mallit të ofruar nga BOE ankimes. Ka pasur raste që ju si autoritet keni pranuar dhe alternativa të ndryshme nga ato të kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit. A ka ndryshim thelbësor produkti i sjellë nga BOE ankimes me atë të kërkuar në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi?

Përgjigjia e autoritetit kontraktor është si vijon: Keni pasur kohe 7 dite te benit ankim kundër kriterëve dhe specifikimeve teknike te percaktuara qarte në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për artikujt 54,55,56 ju keni sjelle të markuar ne katalog vetem nje artikull me pretendimin se kjo stente hapet me ndihmën e ballonit. Pra nga tre stenta ju keni sjelle vetëm 1. Ju cedoni me tre artikuj dhe kështu ne shkelim barazinë në tendera. Keni thënë vetëm se me anë të një balloni mund të zgjeroni stentat. Keni sjelle dokumentacion për ballonin: Iso per ballonin? Keni sjelle CE per ballonin përgjigjja është jo.

Ndërsa mjeku specialist në cilësinë e anëtarit të KVO ka deklaruar se – Eshte i vetmi operator qe ka ofertuar me 4 mm. Në katalogun e paraqitur nga BOE ankimes ka stenta me diametër 4 mm dhe nuk ka stenta 4.5 as 5mm. Nuk eshte e parashikuar ne dokumentata e tenderit stenta me dimatër 4 mm të cilat mund të zgjerohen me anë të ballonit për të arritur një përmasë X. Ndryshon procedura ne dokumentat e tenderit nuk parashikohet, kaq e thjeshte eshte per mua. Nuk kam asgjë për të shtuar nga sa është deklaruar në procesverbalet e KVO-së.

Mund te jete shumë i mire stenti i ofruar por autoriteti kontraktor nuk e parashikon kete lloj procedure. BOE ankimes nuk ka paraqitur asnje studim të mirëfilltë sikundër pretendon. BOE

ka paraqitur edhe një dokument Studim Xience Expandable i cili në përmbajtje nuk është studim i mirëfilltë por është një vlerësim përmbledhës i disa ekspertëve në fushën e kardiologjisë ku citohet se sipas kompanisë Abbott stenti Xience Sierra ofron post –dilatacion deri në 5.5 mm për stentat me diametër 3.5-4.0 mm, por në këtë dokument nuk citohet që postdilatacionin nuk dëmton strukturën e stentit gjatë përdorimit. Pavarësisht se në praktikën klinike ndërkombëtare ky stent mund të jetë i përdorur në dokumentacionin e tenderit të këtij BOE nuk janë paraqitur studime multicentrike të randomizuara ku provohet që cilësia e post dilatacionit të stentit Xience Sierra të jetë aplikuar dhe të ketë patur sukses. Sipas vlerësimit të vetë ekspertëve në dokumentin Studim Xcience Expandable janë duke u zhvilluar studime specifike për stentin Xience Sierra studime të cilat ende nuk kanë përfunduar, që mund të sjellin përveç të tjerave edhe një konkluzion mbi efikasitetin e post dilatacionit të këtyre stentave. Gjithashtu në dokumentin me emërtim Xience Sierra Everolimus Eluting Coronary Systems, pika 2.0 Indication (faqe 10) të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në këtë procedurë, thuhet se: Sistemi i Stentit Xience Sierra indikohet për përmirësimin e diametrit të lumentit të arteries koronare tek pacientët duke përfshirë ata me diabet, me sëmundje inshemike të zemrës simptomatike si pasojë e lezioneve të arterieve koronare me gjatësi nën dhe deri 32 mm me dimatër referencë të enës më e madhe ose e barabartë me 2.25 mm deri në me e vogël baras 4.25 mm.

III.1.13. Gjithashtu Komisioni i ka drejtuar pyetje përfaqësuesëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se : “Në procedurën e prokurimit janë përcaktuar qartë përmasat për mallrat objekt prokurimi. Ju pranoni se keni sjellë mall me të njëjtat specifikime për të gjithë artikujt e tjerë dhe vetëm për artikujt 54,55,56 keni sjellë stenta me dimetër të ndryshëm nga ajo e kërkuar? Përse vetëm për këtë artikuj nuk plotësohen specifikimet teknike cilat janë argumentat tuaja? A keni paraqitur ndonjë kërkesë për sqarim pranë autoritetit kontraktor për aq sa parashikojnë

Përfaqësuesi i BOE ankimues është përgjigjur si vijon: Në rradhe të parë ne nuk kemi pasur paqartësi ne lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi sepse duke pasur stentat e kërkuara nuk kërkuam sqarime shtesë. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të arrihet diametri 4.5 mm dhe 5 mm dhe duke qene se janë vetëm 3 cope ne 1500 e totalit të stentave te kerkuara qe më shumë jane per arsye sigurie se stenta te tilla nuk para ka mund ta imagjinosh sa paciente mund të ketë. Ne kemi ofruar nje nga stentat me te mira në botë. Ne kemi dorëzuar manualet e perdorimit ne sistem ne lidhje me sigurine e përdorimit të stentave të ofruara. Ne lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se kemi paraqitur nje nga tre artikuj nuk eshte e vertete pasi ne do sjellim një numër stentash aq sa janë kërkuar. Secila stente përdoret në mënyre individuale. Me vjen keq që ministria nuk e ka pranuar një ofertë speciale duke i dhënë mundesi të shpëtoje 270 milion lekë.

Përgjigje përfaqësuesi i BOE i deklaruar në seancë në cilësinë e personit të specializuar me profesion Mjek- Stenda Sierra ka nje dizajn të vecantë e cila na lejon ne të bëjmë postdilatin. Ka stenda qe nuk lejojnë hapje dhe ka stenda qe lejojnë hapjen. Ato shkojne ne diameter deri ne 5.5 mm pa shkurtuar gjatësinë e stendës. Nese stenta zgjerohet ajo nuk

shkurton gjatesinë. Ajo fryhet në dimensionin e kërkuar. E dyta e rendesishme polimeri e cila mban ilacin citostatik brenda stentës kur hapet nuk krijon asnjë krisje që të shkaktojë problem. Eshtë shpikur dhe miratuar nga FDA amerikane. Jane stenta që prodhohen në Kaliforni. Para kemi një opozicion të pakuptueshëm sepse është stenta më e mirë. Fakti është që ne kemi ofruar stentën me dimensionin e kërkuar, ju doni përmasën dhe e keni atë nuk ka rëndësi mënyra si arrihet. Predilatacioni, futja e stentit, dhe postdilatacioni është protokoll. Ne nuk u cmendëm të rrezikojmë jetën e pacientit. E kemi sjelle 99.9 për qind brenda sigurisë normale të jetës. Te gjitha studimet janë në favor të stentave që kemi ofruar dhe me cmimin më të mirë të mundshëm.

III.1.14. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se konflikti administrativ mes palëve, autoritetit kontraktor dhe BOE ankimues lidhet në thelb me faktin nëse stentat e ofruara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues janë efektive të përshtatshme për tu përdorur pa rrezikuar jetën e pacientëve. Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në parimin e transparencës dhe barazisë, vlerëson dhe merr në konsideratë deklaratimet e ekspertit të fushës, në seancë dëgjimore ku u theksua me bindje se përdorimi i stentave të ofruara nga BOE ankimues megjithëse të një cilësie shumë të mirë, nëse zgjerohen në përmasat e kërkuara në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi, rrezikojnë jetën e pacientëve, për shkak se zgjerimi në ato përmasa mund të dëmtojë stentin duke rrezikuar ta thyejë atë. Eksperti thekson se zgjerimi i stentit është i rrezikshëm dhe në një kohë i panevojshëm në kushtet kur ekziston mundësia të zgjedhim stenta me dimensionet e kërkuara pa marrë asnjë risk përsipër për trajtimin e pacientëve.

III.1.15. Në analizë sa më sipër sqaruar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në dy elementë në interpretim dhe kuptim të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, së pari në rast se mallrat e ofruara nga BOE ankimues për artikujt 54,55,56 përmbushin specifikimet teknike të kërkuara dhe së dyti në rast se autoriteti kontraktor ka zbatuar drejtë parimin e barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve. Në lidhje me çështjen e parë, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se në nenin 23 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*” Gjithashtu, në nenin 27 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së **dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.***”

Sa më sipër, KPP gjykon se produkti i dorëzuar nga BOE ankimues nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara dhe nuk është i pranueshëm për funksionet e kërkuara, pasi referuar

deklarimeve të ekspertit të fushës përdorimi i tyre rrezikon jetën e pacientëve që do të trajtohen dhe nuk ka arsye të merret një risk i tillë përsipër në kushtet kur operatorë të tjerë kanë ofertuar stenta me dimensionet e kërkuara. KPP gjykon se në rastin konkret qëllimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi është që autoriteti kontraktor të përfitojë mall me të njëjtat cilësi dhe karakteristika si ajo e kërkuar në specifikimet teknike dhe më tej nëse malli i ofertuar nga BOE ankimues me dimensione të ndryshme nga ato të kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, sjell direkt apo indirekt pasoja negative në shëndetin e pacientëve që do të trajtohen. Në rastin konkret bazuar në deklaratimet e ekspertit në seancë dëgjimore si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e autoritetit kontraktor dhe nga BOE ankimues rezultoi se mallrat e ofruara nga ankimuesi për tre artikuj me nr. rendor 54,55,56 me dimension 4 mm nuk përmbushin specifikimet teknike në kuptim të asaj që është kërkuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, dhe nuk japin garanci lidhur me mosrrezikimin e jetës së pacientëve gjatë trajtimit të tyre, për sa kohë që ekziston mundësia e dëmtimit/ thyerjes së stentave gjatë procedurës së zgjerimit në përmasat e kërkuara. Akoma më tej nga shqyrtimi i dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk rezulton të jetë parashikuar mundësia e pranimit të alternativave.

III.1.16. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi, në respekt të parimit të barazisë dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve parashikuar nga neni 2 gërma “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i BOE “GP Medical AI” & “Medikanova” Shpknpj nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyen tjetër të skualifikimit të BOE “GP Medical AI” & “Medikanova” Shpknpj, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër gjykon se

nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e BOE ankimues, do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “GP Medical AI” & “Medikanova” Shpknjp për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-64825-07-09-2020 me objekt Loti 7 “Drug-eluting stent for restenosis-stenta të medikuara për restenozë” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 127,480,750 (njëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1479 Protokoli, Datë 12.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri